

Pas abortit

Gjakderdhja dhe dhimbjet e barkut pas ndërprerjes së shtatzënisë janë normale.

Në ndërprerjen e shtatzënisë me anë të medikamenteve gjakderdhja mund të zgjas me tepër.

Kujdesuni për veten për disa ditë pas ndërprerjes së shtatzënisë.

Për të evituar infeksionet, ju nuk duhet të bëni banjë (bërja e dushit lejohet), nuk duhet të përdorni tamponë si edhe të mos kryeni marrëdhënie seksuale.

Nëse do të keni temperaturë të lartë (mbi 38,5 gradë) për disa ditë me radhë ose sekrecione me erë të keqe, atëherë ju duhet të shkoni tek mjeku.

Menjëherë pas ndërprerjes së shtatzënisë fillon një cikël i ri.

Kjo do të thotë, që ju mund mbeteni sërish shtatzënë. Nëse nuk dëshironi, ju duhet ta evitoni këtë në mënyrën e duhur. Te gjinekologu/-ja ose në një nga qendrat e autorizuara të konsultës, ju mund të konsultoheni mbi metodat e duhura kontraceptive.

Qendra e këshillimit pranë jush

Punonjëset dhe punonjësit në qendrat e këshillimit janë të detyruar të ruajnë sekretin e pacientit.

Ndaj, ju nuk kenipërse të frikësoheni, që një person tjetër mund të mësoj detaje mbi konsultën tuaj.

Adresat e qendrave të këshillimit pranë jush, do t'i gjeni në faqen www.familienplanung.de

Adresat e qendrave të këshillimit të profamilia do t'i gjeni edhe në faqen www.profamilia.de

Impressum: © 2015, **pro familia** Deutsche Gesellschaft für Familienplanung, Sexualpädagogik und Sexualberatung e. V., Bundesverband, Stresemannallee 3, 60596 Frankfurt am Main, Telefon 069 / 26 95 77 90, www.profamilia.de, 1. Auflage 2015, 20.000
Financuar nga Qendra Federale për Edukimin Shëndetësor (Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung – BZgA).
Redaksia: Claudia Camp




Kurzinfo: Schwangerschaftsabbruch nach
Beratungsregel - Albanische Fassung

pro familia

INFORMACION I SHKURTËR

**NDËRPRERJA E
SHTATZËNISË
KONFORM KONSULTËS**

SHQIP



Ju jeni shtatzënë dhe mendoni mbi një abortim të mundshëm?

Vetëm ju mund ta merrni vendimin mbi ndërprerjen e shtatzënisë dhe askush tjetër. Në Gjermani aborti është i padënueshëm nëse ju respektoni këto tre gjëra:

1. Ju duhet të kryeni një takim konsulte në një **qendër këshillimi për konfliktet e shtatzënisë, e cila të jetë njohur zyrtarisht**.
Kjo konsultë është falas.
Pas takimit, ju do të merrni një **vërtetim konsulte** nga kjo qendër.
Këtë ju duhet ta paraqisni pranë klinikës, në të cilën do të kryhet edhe ndërprerja e shtatzënisë.
2. Nga dita e konsultës deri në ditën e abortit duhet të kalojnë patjetër tre ditë.
3. Shtatzënia lejohet të ndërpritet vetëm deri në fund të javës së 12 (përkatesisht 14 javë pas ditës së fundit të menstruacioneve). Aborti mund të kryhet vetëm prej një mjeku apo mjekjeje.
Mosha e shtatzënisë do të caktohet vetëm nga mjekja apo nga mjeku.

Në qendrën e këshillimit, ju mund të merrni edhe adresat e mjekëve apo mjekjeve, të cilët kryejnë aborte.

Informacione mbi ndërprerjen e shtatzënisë pas një akti të dhunës ("kriminologische Indikation") ose për arsye mjekësore, do të gjeni në broshurën e detajuar "Ndërprerja e shtatzënisë" („Schwangerschaftsabbruch“, e disponueshme në gjermanisht, anglisht, rusisht, turqisht, kroatisht, polonisht), www.profamilia.de/publikationen

Sa kushton kjo?

Nëse ju vetë fitoni mjaftueshëm, atëherë ju duhet ta paguani vetë ndërprerjen e shtatzënisë.
Kjo ju kushton ndërmjet 270 dhe 500 €.

Nëse ju merrni **ndihmë sociale, ALG 2** apo përfitime sipas **ligjit për përfitimet e azilkerkuesve**, atëherë ju nuk jeni të detyruar të paguani vetë ndërprerjen e shtatzënisë.
Bundesland-i, në të cilin ju jetoni, do të mbulojë në këtë rast këto shpenzime.

Për këtë ju duhet të shkoni te një **sigurim shëndetësor publik** (si për shembull **AOK**) dhe të pyesni për një vërtetim për marrjen përsipër të shpenzimeve ("**Kostenübernahmebescheinigung**").

Ju duhet të merrni dokumentet tuaja me vete, të cilat vërtetojnë, që ju jetoni në Gjermani dhe sa para merrni.

Vërtetimin për marrjen përsipër të shpenzimeve ("Kostenübernahmebescheinigung") ju duhet ta siguronit dhe paraqisni **para** ndërprerjes së shtatzënisë pranë klinikës, në të cilën do të kryhet edhe ndërprerja e shtatzënisë.

Në klinikën e mjekut

Për ndërprerjen e shtatzënisë, sillni në klinikë dokumentet e mëposhtme:

1. **Vërtetimin e konsultës („Beratungsbescheinigung“)**
2. **Vërtetimin për marrjen përsipër të shpenzimeve ("Kostenübernahmebescheinigung")** ose honorarin e mjekut në të holla.
3. **Kartën e sigurimit shëndetësor** ose dëftesën për trajtim mjekësor apo rekomandimin nga mjeku.
4. **Dëshminë mbi grupin e gjakut**, nëse e dispononi

Mjeku ose mjekja do të zhvillojë me ju një bisedë para ndërprerjes së shtatzënisë.

Ai ose ajo duhet t'ju shpjegojë saktësisht hapat e ndërhyrjes si edhe duhet t'ju informojë mbi rreziqet e lidhura me të.

Mjeku apo mjekja mund ta kryejë ndërprerjen e shtatzënisë, vetëm nëse ju i keni kuptuar informacionet gjatë bisedës.

Nëse ju flisni pak apo aspak gjermanisht, atëherë ju duhet të sillni me vete dikë, i cili mund t'ju përkthejë bisedën dhe informacionet.

Ndërprerja e shtatzënisë

Pjesa më e e madhe e aborteve kryhen si **ndërhyrje ambulatore me metodën e thithjes vakum**.

Pas disa orësh ju mund të ktheheni sërish në shtëpi.
Ndërprerja e shtatzënisë mund të kryhet me narkozë të plotë ose me mpirje lokale.

Pas narkozës qafa e mitrës do të hapet pak nga pak e me kujdes, me anë të një shufre të vogël metalike.
Më tej, masa indore e shtatzënisë do të thithet përmes një tubi me anë të aparaturës thithëse.
Ndërhyrja zgjat vetëm disa minuta.

Shtatzënia mund të ndërpritet edhe me anë të medikamenteve.

Këto do të merren (pjesërisht) nën mbikëqyrjen e mjekut.
Ndërprerja e shtatzënisë me anë të medikamenteve është e mundur deri në javën e 9. të shtatzënisë.
Për ndërprerjen e shtatzënisë me anë të medikamenteve ju duhet të vini të paktën dy herë, në disa raste edhe tre herë në klinikë.